



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-30547/23 datë:17.11.2023



Npi – 01/427 datë: 27.11.2023

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe neni 17 shkronjat (k) dhe (l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Ligji për Financimin e Programeve të Veçantë të Banimit Nr.03/L-164; Udhëzuesi për hartimin e Programeve komunale trevjeçare të banimit; Si dhe duke u bazuar në rekomandimin e Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës Nr.3808-2/23 të datës: 18.07.2023, për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/271 të datës 06.07.2023 për Programin tre vjeçar për banimit social 2023-2025. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 27.11.2023 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR KORRIXHIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
Npi-01/271 SIPAS REKOMANDIMIT TË MMPHI-së

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.11.2023, unanimisht miratoi, vendimin për korrixhimin e bazës Ligjore të Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-01/271, dt. 06.07.2023, për Programin e banimit social 2023-2025 (Sipas rekomandimit të MMPHI Nr.3808-2/23 më datë: 18.07.2023), si vijon:

1. Hiqet nga preambula e Vendimit Npi-01/271, dt.06.07.2023 për Programin tre vjeçar për banimit social 2023-2025, teksti si vijon: “*Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore Nr.04//L-061*” pasi që nuk është në fuqi.
2. Në dokumentin final të Programit komunal tre vjeçar për banim social 2023-2025, te faqja e 5 poshtë titullit “Drejtoritë kompetente për zhvillimin e projekteve të programit” janë numëruar si vijon:
 - Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale,
 - Zyra Komunale Financiare,
 - Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe
 - Drejtoria për Shërbime Publike.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi